



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.04, datë 08.03.2023

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS:
“NDËRTIMI I AKSIT RRUGOR THUMANË - VORË - KASHAR”, LOTI I, II, III DHE IV
ME VENDNDODHJE NË BASHKITË TIRANË, VORË DHE KRUJË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, koncesionarin “Gener 2” sh.p.k dhe shoqërinë koncesionare “G2 Infra” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës: “Ndërtimi i aksit rrugor Thumanë - Vorë - Kashar”, Loti I, II, III dhe IV, me vendndodhje në Bashkitë Tiranë, Vorë dhe Krujë, me subjekte zhvilluese Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, koncesionarin “Gener 2” sh.p.k dhe shoqërinë koncesionare “G2 Infra” sh.p.k.
2. Hartat e Planvendosjes së Strukturave për secilin Lot, bashkëlidhen si pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Dokumentet e Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues sipas Loteve të poshtëshënuara
 - Loti I, Km 0+000 deri në Km 8+500;
 - Loti II, Km 8+500 deri në Km 14+275;
 - Loti III, Km 14+275 deri në Km 20+250;
 - Loti IV, Km 20+250 deri në Km 21+048.

vetëm pas:


- a) plotësimin të dokumentacionit tekniko-ligjor;
- b) pagesës përkatëse të taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkive Tiranë, Vorë dhe Krujë.



4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

